



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 445 Prot.

Tiranë, më datë 01.11.2019

**VENDIM**

**Nr.365, datë 01.11.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, pas shqyrtimit më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 01.11.2019,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projekt - propozimit për qendër informacioni në fshatin Dhërmi, pjesë e projektit “Rivitalizimi i Qendrës historike Dhërmi”, me investitor Fondin Shqiptar të Zhvillimit;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR I KKR**

**Arta Dollani**